



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, dëshmitari i katërt i thirrur nga Mbrojtja e Thaçit, Xhejms Kovi (James Covey) përfundoi dhënien e dëshmisë të enjten që shkoi. Seanca e ardhshme në këtë gjykim është caktuar për të hënë, 27 tetor 2025, në orën 09:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, version i redaktuar publik i Dosjes Paraprake të Prokurorisë, i datës 19 shtator, u dorëzua javën që shkoi dhe mund ta gjeni në faqen tonë të internetit. Dosja Paraprake përfshin përmbledhjen e Prokurorisë të provave që synon të paraqesë gjatë gjykimit për secilën prej akuzave, ndër të cilat transkripte të incizimeve të autorizuar nga gjykata, të bëra gjatë vizitave në objektin e paraburgimit.

Bazuar në këto incizime dhe prova të tjera në dosjen paraprake, Prokuroria pretendon se gjatë këtyre vizitave personale në objektin e paraburgimit, z. Thaçi "në mënyrë të përsëritur, të qëllimshme dhe të paligjshme nxori informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të ZPS-së, me vetëdije zbuloi identitetet dhe provat e tyre në shkelje të urdhrave të gjykatës, dhe dha udhëzime konkrete si duhet të dëshmonin dëshmitarët ..." Dosja përshkruan gjithashtu pretendime dhe prova që do të paraqiten lidhur me rolin që luajtën katër të akuzuarit e tjerë në këtë çështje gjyqësore.

Të pesë të akuzuarit janë vetëdeklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka ftuar gjithashtu ekipet e Mbrojtjes të dorëzojnë dosjet paraprake të tyre, nëse dëshirojnë, deri më 20 tetor 2025.

Kujtojmë se Gjykatësja i ka njoftuar palët se synon t'ia kalojë çështjen trupit gjykues në gjysmën e parë të nëntorit, në varësi të vendimeve që do të jepen nga Paneli i Gjykatës së Apelit.

Në lidhje me të njëjtën çështje gjyqësore, një vendim i Gjykatësit të Vetëm nga viti 2023 u bë publik javën që shkoi, në të cilin ai trajtoi një kërkesë të Mbrojtjes për masa për të garantuar komunikimin konfidencial midis z. Thaçi dhe avokatëve të tij, duke pasur parasysh masat hetimore të posaçme që Gjykatësi kishte autorizuar për disa vizita në kuadër të hetimit. Gjykatësi miratoi kërkesën e Mbrojtjes për dhënien e garancive se komunikimet e privileguara midis të akuzuarit dhe avokatëve të tij nuk ishin incizuar. Ai konfirmoi se për asnjë vizitë të privileguar me avokatët nuk ishte urdhëruar incizim dhe se, pas shqyrtimit të raporteve relevante, Gjykatësi nuk ishte në dijeni për ndonjë incizim, të qëllimshëm apo të paqëllimshëm, të vizitave të privileguara gjatë periudhës përkatëse.





Më 3 tetor, dhe në vendime më vete për secilin, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdoi paraburgimin e z. Thaçi, z. Smakaj, z. Fazliu dhe z. Kilaj. Kujtojmë se i akuzuari i pestë në këtë çështje gjyqësore nuk është në paraburgim.

Për secilin prej katër të akuzuarve për të cilët u vazhdua paraburgimi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vlerësoi bazuar në ligj nëse ekziston rreziku që i akuzuari të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejë vepra penale të tjera. Për secilin prej të akuzuarve ajo konstatoi se këto rreziqe vazhdojnë të ekzistojnë. Ajo vlerësoi gjithashtu nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen nëpërmjet masave të tjera përveç paraburgimit, dhe nëse paraburgimi është proporcional. Sipas ligjit, rishikimet e ardhshme të paraburgimit për këta të akuzuar do të kryhen brenda dy muajve të ardhshëm.

